




Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec
Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Rahovecit
Nr.02-/2019
Me 19.03.2019



Lënda: RAPORTI I PUNËS TË NJAB-së

Për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018.

(i formës së shkurtër)

19.03.2018

Raporti i punës së NJAB-së për vitin 2018

Në kuadër të këtij dymbëdhjet mujorshi, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të punës për vitin 2018, i cili Planë ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për vitin 2018, kanë qenë të planifikuara 10 Auditime.

Prej tyre një auditim është i planifikuar të bëhet me kërkesë të menaxhmentit të lartë të Komunës.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet të planifikuara dhe të kryera për vitin 2018 sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

N.r.	Drejtoritë e synuara të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara për vitin 2018	Shkalla e rrezikshmërisë sipas Planifikimit
1	Auditimi në Drejtorin për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mrojtje të Mjedisit. Menaxhimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e lejeve për ndërtim dhe rregullimin e tokës ndërtimore. Dhe Shpenzimet.	Rrezik i mesëm
2	Auditimi në Drejtorinë për Punët Inspektuese. Menaxhimi i të hyrave nga taksat për punë inspektuese.	Rrezik i mesëm
3	Auditimi në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë. Menaxhimi i të hyrave nga taksat për shërbimet Kadastrale dhe Gjeodezike Dhe Shpenzimet	Rrezik i mesëm
4	Auditimi në Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport. Menaxhimi i të hyrave nga taksat për shfrytëzimin e sallave, stadiumeve dhe antarsimi në bibliotek Dhe Shpenzimet	Rrezik i mesëm
5	Auditimi në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim Menaxhimi i të hyrave nga qiraja e pronës komunale. Menaxhimi i të hyrave nga tarifë ngarkesat e subjekteve afariste. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Pasurisë.	Rrezik i mesëm
6	Auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi (QKMF) Menaxhimi i të hyrave nga Participimi Menaxhimi i personelit Menaxhimi i Stogëve nga Barnat esenciale e tjera	Rrezik i Lartë
7	Auditimi në Drejtorin e Admistratës të Përgjithshme Menaxhimi i të hyrave nga Shërbimet administrative Menaxhimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve	Rrezik i mesëm
8	Auditimi Ad-hoc në Drejtorin e Komunale të Arsimit	Rrezik i Mesëm
9	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa: Procesi i shpenzimeve për të gjitha drejtoritë Komunale (me përjashtim të	Rreziku i Lartë

	Drejtoria e Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë)	
10	Auditimi në Drejtorinë për Shërbime publike, Komunale Menaxhimi i të hyrave nga taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike dhe për dhëjen me qira të hapësirës publike.	Rrezik i Mesëm
11	Auditimi në ZYRËN E PROKURIMIT - Inicimi i aktiviteteve të Prokurimit - Proceset e Prokurimit për Mallra dhe Shërbime. - Prokurimi i Investimeve Kapitale	Rrezik i Lartë

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2018 – 2020, planë ky i aprovuar po ashtu nga Kryetari i Komunës.

Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm :

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit vjetor të NJAB-së për vitin 2018.
- Në muajin shkurt është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2018.
- Është raportuar Kryetarit dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm për punën e NJAB-së për vitin 2018,
- Raportin e gjashtëmujorshit të parë dhe të dytë, dhe Raportin Vjetor të NJAB-së për vitin 2018 i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Si aktivitete tjera mund të cekem ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rrezeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke krijuar një regjistër me rreze të identifikuara ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Vlerësimi përmbyllës:

Në këtë vit 2018 NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor, me që ka arritur ti kryej dhjetë (10) auditime dhe një auditim ad-hoc (me kërkesë të Kryetarit) të cilat kanë pasur një fushveprim mjaftë të gjërë dhe kompleks,

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të Drejtorisë së audituar i janë dhënë rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve. Pra është arritur të krijohet një bashkpunim produktiv në mesë NJAB-së dhe menaxhmenteve komunale.

Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit janë 52 rekomandime, 31 rekomandime janë të implementuara dhe 21 rekomandime janë pjesërisht të implementuara , që presim në vitin aktual të implementohen.

Kërkohej një angazhim më konkret i menaxhmenteve të Drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga Auditori i Përgjithshëm ashtu edhe nga Auditori i Bren

Drejtori i NJAB-së:

